



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000011/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Bulqizë.

Drejtuar: Z. Vilson BALA
Shef i Komisarimit

BULQIZË

Për dijani: Drejtues i parë Skënder KALEMI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

DIBËR

I nderuar z. Bala,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Bulqizë.

Inspektimi u krye në datën 06.11.2019, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Genci Tërpo me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe z.Sotiraj Nushi me detyrë Nd/komisionerë pranë Seksionit të Veçantë.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standarteve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e vitit të kaluar.

¹ Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Bulqizë, z.Vilson Bala, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, Shefi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në inspektimin e mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve sipas procedurave standarde të dhomave të shoqërimit të këtij Komisaritati.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e inspektimit, vijoi takimin edhe me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe të shërbimeve të tjera. Theksojmë se, Shefi i Komisarariatit dhe punonjësit e policisë u treguan shumë bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit, që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Grupi i punës në vijim inspektoi dhomat e shoqërimit, zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga informacioni dhe verifikimi në vend i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar, grupi i inspektimit konstatoi se:

- **Ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin dhe vënien në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisariatin e Bulqizës, me 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete për personat e rritur, femra dhe të mitur, si dhe të pajisura me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.
- Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se, **nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e zyrës ku merren në pyetje/intervistohen shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
- Gjithashtu, **nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në zyrën ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, si dhe në korridorin e ambientit të shoqërimit.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues vëren se megjithëse në Komisariatin e Bulqizës ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë ambienti i shoqërimi në tërësi ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës

standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, duke krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për femra, personat e rritur dhe të miturit.²

Në këtë Komisarariat, ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës kryesore. Ai përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi, të ndara më vete për femra, personat e rritur dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijonin mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Ngjitur me dhomat e shoqërimit, ndodhej një tualet i përbashket, por nuk ishte i ndarë për femra dhe meshkuj dhe i pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim³, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Në dhoma dhe mjediset e tjera brenda ambientit të shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për përdorimin e dhunës apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Dhomat e shoqërimit ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare, por nuk kishte sistem ngohjeje apo paisje të tjera elektrike, nisur nga kushtet e vështira atmosferike të kësaj zone.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë më vete për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar dhe të mitur. Kjo procedurë ndiqej nga punonjësit e policisë deri në përfundim të veprimeve procedurale me personat e shoqëruar, në zyrat e tyre të punës.

Në këtë Komisarariat nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatin e Policisë Bulqizë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin menjëherë pas përfundimit të veprimeve procedurale, në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Dibër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, si dhe trajtimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatin e Policisë Bulqizë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*” dhe ishte i sekretuar.

² Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”

³ Kreu VI, pika 3/c e procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policies, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësi i policisë në zyrën e informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Në këtë Komisariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Bulqizë, punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.⁴

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

⁴ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me Avokat, që në momentin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Bulqizës.

Ndërkohë u konstatua se, në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të aktit të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse⁵.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomën e shoqërimit të këtij Komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme në Komisariatin e Policisë Bulqizë, për krijimin e zyrës të përshtatëshme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar dhe të mitur gjatë kryerjes së veprimeve procedural, nga oficerët e policisë gjyqësore.
2. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në zyrën ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, në ambientet e këtij komisaritati, si dhe në korridorin e dhomave të shoqërimit.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për trajnimin e instruktimit të stafit të punonjësve të policisë, në zbatim të Kodit të ri të Procedurës Penale, për dhënien e letrës me të

⁵ Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”

drejtat e njeriut, çdo personi nën hetim ose i pandehur, si dhe për plotësimin e regjistrit me të dhënat e personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar, sipas të gjitha rubrikave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA